



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE



Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2019

Lënda: Propozim për zgjedhjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

Drejtuar: **Zotit Gramoz RUÇI**
KRYETAR I KUVENDIT

Këtu

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Me Vendimin e Kuvendit nr. 85/2014 datë 30.10.2014, Kuvendi I Shqipërisë ka plotësuar vakancën për Komisioner për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe ka zgjedhur në këtë detyrë znj. Pranvera Strakosha.

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 152/2013 **“Për Nëpunësin Civil”**, *i ndryshuar*: “Komisioneri zgjidhet nga Kuvendi, për një afat 5-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë”.

Me Vendimin nr. 2 datë 30.09.2019, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si komision përgjegjës ka shpallur vakancën për pozicionin Komisioner për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil i cili në datë 01.10.2019 është publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë, pasi mandati i Komisionerit mbaron në datë 30.10.2019.

Pas njoftimit të bërë publik, në respektim të afatit 20 ditor të përcaktuar në pikën 2, të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, ka shprehur interes një kandidaturë e vetme dhe përkatësisht znj. Pranvera Strakosha, aktualisht në detyrë Komisionere për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në datë **24** tetor 2019, *në cilësinë e komisionit përgjegjës*, në bazë të Rregullores së Kuvendit zhvilloi procedurat parlamentare për seancën dëgjimore dhe shqyrtimin e të vetmes kandidaturë të vetofruar për detyrën e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Komisioni vlerësoi se kandidatura e zonjës Pranvera Strakosha plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 12 dhe 21, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, si dhe kriteret e papajtueshmërisë me funksionin Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Komisioni gjykoi se kjo kandidaturë plotëson kriteret e meritës profesionale për ushtrimin e funksionit të propozuar.




Zonja Strakosha, ka qënë pjesë e sistemit gjyqësor, si gjyqtare dhe zëvendëskryetare e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe gjithashtu ka qënë e zgjedhur nga Kuvendi si anëtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Gjithashtu znj. Strakosha në mandatin e saj 5-vjeçar ka dhënë një kontribut të vyer në drejtimin e institucionit, krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike.

Për sa më lartë,

Ne, një grup prej 28 deputetësh, duke vlerësuar rëndësinë e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil si dhe duke marr parasysh vlerësimin e Komisionit përgjegjës për sa i takon përmbushjes së kriterëve ligjore nga ana e kandidaturës, i paraqesim Kuvendit mbështetjen tonë me 28 firma, sipas nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, për kandidaturën e znj. Pranvera Strakosha për t'u rizgjedhur si Komisionere për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

GRUPI I DEPUTETEVE PROPOZUES:

1. Toulan Belle 
2. Ewan Buzarov 
3. Arben Pellumb 
4. Mily Ibrahim Hysen
5. Fadil Nampi Induruf
6. Bujan Ceta 
7. Edmond Ibra 
8. Bashkim Filmo 
9. Luca Housha 
10. Adelin Rista 
11. Ismet Begdaj 
12. Lindita Vukob 
13. Vilma Bulo Vukob
14. Musa Ugras 

15. Fidel Ylli juu
16. ULSI MANSA auey
17. Elong Hothp JH.
18. Garmek Valikaj auey
19. Ambmetq Nume JH
20. SADI VORPSI juu
21. Anber Kamani
22. Florenc Spaho JH
23. Vullret liug JH
24. Beink Barog JH
25. Eljo Hysko JH
26. Edhna Bode Bode
27. Robert Aralay JH
28. Nue Hduoklu JH